



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:263133  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05505151

PML.nr.50/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoresh profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: M. H., për shkak veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së dhe B. H., për shkak veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, P.nr.397/18 të datës 01.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1311/23 të datës 17.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 13.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve: M. H., dhe B. H., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, P.nr.397/18 i datës 01.09.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1311/23 i datës 17.11.2023 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.397/18 e datës 01.09.2023, të dënuarin M. H., e ka shpallur fajtor për shkak veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 2 të KPRK-së dhe veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve, në të cilin dënim do t’i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 20.09.2018 deri më 06.11.2018, e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pasi që ky

aktgjykim të merr formën e prerë dhe dënim unik me gjobë në shumë prej dymijepesëqind (2500) Euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

I dënuari B. H., është shpallur fajtor për shkak veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) muajve, në të cilin dënim do t’i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 20.09.2018 deri më 06.11.2018, e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe dënim unik me gjobë në shumë prej njëmijetreqind (1.300) Euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë do të zëvendësohet me dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do të caktohet nga një (1) ditë burgim. Janë detyruar të dënuarit që secili veç e veç të paguajnë në emër të shpenzimeve të procedurës penale paushallin gjyqësor shumë prej njëzet (20) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, ndërsa palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1311/23 të datës 17.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit M. H., avokati Fisnik Sogojeva, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1 dhe neni 9 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe t’i anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo t’i ndryshojë aktgjykimet dhe të dënuarit t’i shqipton dënim me kusht dhe
- mbrojtësja e të dënuarit B. H., avokatja Sarandë Beqiri, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 dhe neni 9 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe t’i anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo t’i ndryshojë aktgjykimet dhe të dënuarit t’i shqipton dënim me kusht.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.24/24 të datës 29.01.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilat për nga përmbajtja janë identike, mbrojtësit e të dënuarve: M. H. dhe B. H., theksojnë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe me shkelje të ligjit penal. Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë bërë shkelje ligjore në mënyrën e aplikimit të dispozitave ligjore lidhur me përcaktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit sepse të njëjtit janë trajtuar pa të drejtë si recidivist, ndërsa rrethanat tjera rënduese të cilat i ka vlerësuar gjykata si përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e të dënuarve janë elemente të veprës penale, se janë aplikuar dy Kode Penale të ndryshme tek rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe atë gjykata e shkallës së parë ka aplikuar Kodin me nr.04/L-082 e që është më i favorshëm, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka aplikuar Kodin me nr.06/L-074 e që është më pak i favorshëm.

Mbrojtësit e të dënuarve, gjithashtu pretendojnë se palët e dëmtuara nuk mund të kenë cilësinë e palës së dëmtuar sepse personat të cilët në aktakuzat tjera, ku kanë qenë të përfshirë të dënuarit, kanë pas cilësinë e të bashkakuzuarit për veprën penale “legalizimi i përmbajtjes së rreme”.

Po ashtu, si pretendimi tjetër i mbrojtësit të dënuarit M. H., është se i njëjti me aktgjykimin P.nr.12/2021 të datës 23.02.2022 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është shpall fajtor për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të falsifikimit të certifikatës me numër të protokollit L4/7540 të datës 26.04.2016 dhe vërtetimit nr.44428/18 të datës 13.02.2018, për të cilën edhe me aktgjykimin e atakuar është shpall fajtor, pra kemi të bëjmë me situatën kur për të njëjtin veprim/vepër penale është gjykuar dhe dënuar dy (2) herë.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësve të të dënuarve: M. H. dhe B. H., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal, të cilat do të elaborohen në vijim, ndërsa me shkelje të njëjta është përfshirë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, në kuptim të mos vlerësimit në mënyrën e duhur të pretendimeve ankimore dhe mos paraqitjes së arsyeve të mjaftueshme në lidhje me këto pretendime.

Në radhë të parë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin konkret gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë shqyrtuar fare nëse në këtë rast duhet aplikuar parimin “*Ne bis in idem*” që parashihet në nenin 4 të KPP-së. Duke u mbështetur në ngjarjen penale (veprën penale) dhe ecurinë e procesit penal të zhvilluar në këtë çështje penale juridike, rezulton se në raport me të dënuarit M. H., ndodhemi para ndalesës “*Ne bis in idem*”, për faktin se i njëjti me aktgjykimin P.nr.12/2021 të datës 23.02.2022 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është shpallur fajtor për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të falsifikimit të certifikatës me numër të protokollit L4/7540 të datës 26.04.2016 dhe vërtetimit nr.44428/18 të datës 13.02.2018, për të cilën edhe me aktgjykimin e kundërshtuar me kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është shpall fajtor. Në rastin e dhënë kemi të bëjmë me ngjarjen e njëjtë, përkatësisht me falsifikim të certifikatës dhe vërtetimit të lartcekur, për të cilën ngjarje është iniciuar procedura penale sipas aktakuzës PP-II.nr.3234/18 të datës 18.02.2021 dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin e ka shpallur fajtor të dënuarin M. H., për të njëjtin veprim, të kryer në të njëjtën kohë dhe ndaj të njëjtit person dhe është dënuar për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, nga neni 398, paragrafi 1 të KPRK-së.

Nga faktet e përshkruara më sipër, rezultojnë të bazuara pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë se në rastin konkret, çështja në raport me të dënuarin M. H., konsiderohet e gjykuar “*Res iudicata*”, vetëm sa i përket certifikatës dhe vërtetimit të lartcekur, andaj edhe në këtë mënyrë kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal, nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së.

Në anën tjetër, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.7. të KPP-së, të cilat kanë të bëjnë me mos zbatimin në mënyrën e duhur të dispozitave ligjore që i referohen pranimin të fajësisë, nga neni 242, paragrafi 2 të KPP-së dhe mungesës së paraqitjes së arsyeve të mjaftueshme në lidhje me këtë aspekt, për faktin se të dënuarit: M. H. dhe B. H., e kanë pranuar fajësinë dhe gjykata e ka miratuar një pranim të tillë të fajësisë, mirëpo në këtë rast nuk rezulton në mënyrë të qartë nëse në të vërtetë janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, e më specifikisht nëse në veprimet e të dënuarve në fjalë qëndrojnë të gjitha elementet themelore të veprave penale për të cilat janë akuzuar.

Në këtë drejtim, siç është theksuar edhe më parë, të dënuarit: M. H. dhe B. H., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 2 të KPRK-së, e cila vepër kryhet “me paraqitjen e rreme të fakteve, apo duke i fshehur faktet, duke mashtruar apo lajthitur personin tjetër, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër”, ndërsa në rastin konkret nuk kemi një situatë të tillë sepse palët, të cilësuar si palë të dëmtuara (mashtruara apo lajthitura), kanë shfrytëzuar këto vërtetime për të përfituar pensionin e veteranit, e të cilët në rastin tjetër, së bashku me të dënuarit, kanë pasur edhe cilësinë e bashkëkryerësit për veprën penale “*Legalizimi i përmbajtjes së rreme*”. Andaj, përshkrimi i veprës penale “*Mashtrimi*” në dispozitivin e aktakuzës dhe të aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë nuk përkon me elementet e veprës penale “*Mashtrimi*”, nga neni 335, paragrafi 2 të KPRK-së, pasi që në të nuk janë paraqitur të gjitha

elementet e nevojshme për ekzistimin e kësaj vepre penale, ndërsa një e metë e tillë, përbën që aktgjykimi në fjalë të mos jetë hartuar, duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1.1. të KPP-së.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 369, paragrafi 8 të KPP, pasi që në pjesën e arsytimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të kuptueshme, si dhe nuk janë sqaruar në mënyrë të mjaftueshme se pse disa rrethana janë vlerësuar si rrethana rënduese, e që rrjedhimisht kjo pjesë e arsytimit është kundërthënëse.

Kështu, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të lartcekur shihet që gjykata e shkallës së parë i ka marrë për bazë si rrethana rënduese: *“shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e këtyre veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tyre në këtë vepër penale, shkalla e lartë të dëmit të shkaktuar”*, mirëpo nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të kuptueshme, si dhe nuk është sqaruar mjaftueshëm një aspekt i tillë i vlerësimit të këtyre rrethanave.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që t'i aprovojë si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, ndërsa më pastaj duhet të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, kurse nëse arrihet pranimi i fajësisë, atëherë pranimi i fajësisë duhet të jetë në koherencë me shkresat e lëndës dhe me dispozitat përkatëse ligjore që e rregullojnë pranimin e fajësisë.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konkludoi se pretendimet e mbrojtësve janë të bazuara, andaj edhe duke u bazuar në nenin 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.50/2024, më datë 13.03.2024

Bashkëpunëtore profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj